



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më 27.12.2025 protdate

Nr. 489 protnumber

Lënda: Kërkesë për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Drejtuar: **Z. Ilirjan Celibashi**
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisionit Rregullator

I nderuar z. Komisioner,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator,

Me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve.

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 20, pika 1, shkronja "c" e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit.

Nisur nga sa më sipër dhe në përputhje me nenin 16 të Rregullores, po ju paraqesim këtë kërkesë, për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të

Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 4, Tiranë, Shqipëri |



| info@kqz.gov.al | kqz.gov.al | +355 4 4510810

ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Helga VUKAJ

Anëtar i Komisionit Rregullator



Muharrem ÇAKAJ

Anëtar i Komisionit Rregullator

